

Projekti IADSA

Gjimnazi 'A.Z. Cajupi', Tirane

Tematika: *Rekreacion dhe Sport*

Ne kuader te programit IADSA ne gjimnazin 'Cajupi' eshte parashikuar te realizohet komponenti i shkolles komunitare qe ka te beje me '**Rekreacionin dhe Sportin**'. Ky komponent ka si fokus hartimin, organizimin dhe realizimin e nje sere aktivitetesh qe kane si qellim aktivizimin e nxenesve dhe te rinjve ne klube te ndryshme tematike (Sport, Letersi, Art, Kreativitet, Siper marrje, ICT, etj) si dhe testimin e aftesive dhe talenteve me ane te realizimit te aktiviteteve dhe konkurimeve ndermjet shkollave ne nivel lokal dhe rajonal. Po ashty ky komponent synon krijimin e aftesive innovative te shumekerkuara nga tregu si dhe te rekomanduara si strategjike ne dokumentat e ndryshem te EU-se sic jane ato qe lidhen me siper marrjen, inovacionin, kreativitetin etj.

Aktivitetet e parashikuara:

- 1- Nje **analize e detajuar e aktivitetve dhe klubeve** te organizura ne shkolla dhe te aktiviteteve qe ato promovojne dhe organizojne. Analize e ambjenteve te perdorura per realizimin e ketyre aktiviteteve si dhe nje analize e menyres se qeverisje dhe koordiminimit t e tyre.
- 2- **Krijimi I klubeve tematike brenda shkolles** – ne lidhje me aspektet qe kane te bejne me Kreativitetin, siper marrjen, inovacionin, artin dhe kulturen, sportin.
- 3- **Trainimi i nxenesve dhe mesuesve** lidhur me aspektet ligjore dhe manaxheriale per krijimin dhe funksionimin efikas te oragizatave dhe klubeve te ndryshme te shkolles. Menyrat e perfshirjes se komunitetit si dhe te vetemanshimit te burimeve financiare.
- 4- Hartimi i **planit te aktiviteteve** per cdo klub ku do specifikohen takimet qe do organizohen, pjesmarresit, ekspertet, te ftuarit, skedulimin dhe cdo aspekt tjeter qe lidhet me organizimin dhe mbarevajtjen e aktiviteteve.
- 5- **Organizimi i aktiviteteve** – jana parashikuar aktivitete per cdo klub: aktivitete per siper marrjen, kreativitetin, inovacionin, kolegjin e konkurueshmerise, aktivitete sportive etj me pjesemarrjen e ekspertve te huaj de atyre nacional. Keto aktivitete do te realizohen me pjesemarrjen jo vetem te nxenesve dhe stafit te shkolles 'Cajupi' Tirane por edhe te perfaqesuesve nga shkollat e tjera te rrejetit.
- 6- **Krijimi i nje sistemi elektronik** si vitrine per oferten edukative te shkolles, per aktivitetet dhe iniciativat e ndryshme qe ajo ndermerr dhe realizon eshte nje tjeter element me interes qe do realizohet gjate projektit me synim informimin e opinionit publik dhe perfshirjen e tyre ne aspekte te ndryshme. Po ashtu krijimi i nje sistemi të menaxhimit të informacionit në arsim konsiderohet si nje mjet per te krijuar nje lidhje te shkollës me komunitetin, si detyrim për të siguruar arsim të mirë për të gjithë.
- 7- **Realizimi I nderhyrjeve infrastrukturore** per krijimin e nje ambjenti fizik dhe social miqesor qe bazohet ne principet e zhvillimit te qendrueshem per nxenesit, prinderit dhe komunitetin lokal. Nderhyrjet fizike ne mjedis te parashikuar kane te bejne me rehabilitime parziale te ambjenteve te brendshme si rishikimi i sistemit te elektricitiet, sistemit te

ngrohjes, termoizolime, etj, krijimin e ambjenteve te pershtatshme per aktivitetet sportive te shkollave, krijimin e kushteve per nxenesit me aftesi te kufizuar, nderhyrje ne labororet informatike te shkollave si dhe ne biblioteka. Nderhyrjet e parashikuara ne infrastrukture jane:

- a. Nderhyrjet fizike ne mjedis me ane te rehabilitimeve parziale te ambjenteve te brendshme si rishikimi i sistemit te elektricitet, sistemit te ngrohjes, termoizolime, etj.
- b. Rehabilitimi i palestres dhe pajisja e saj me mjete te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e aktiviteteve te ndryshme sportive.
- c. Rishikimi i infrastruktures se bibliotekes (rafteve dhe tavolinave) dhe pasjisa e shkollës me libra te ri (sipas listes se ministrise).
- d. Nderhyrje infrastrukturore per krijimin e kushteve per nxenesit me aftesi te kufizuara (rampa, tualete te pershtatshme)
- e. Nderhyrje ne labororet informatike te shkollave dhe krijimi i nje qendre burimore per shkollen.

8- **Promovim dhe informim** lidhur me aktivitetet dhe iniciativat e ndryshme te organizuara nga shkolla ne kuader te projektit.

9- Pjesemarrje ne krijimin e **Rrjetit i gjimnazeve-model te shkolles komunitare** qe ka si qellim perhapjen e pervojave dhe praktikave me te mira te realizuara ne gjimnaz nepermjet takimeve me perfaqesues te gjimnazeve te rajonit ne nivel DAR/ZA-je, perhapjes se ideve dhe materialeve te projektit ne rrjetet e zhvillimit profesional te mesuesve dhe drejtuesve te gjimnazeve qe funksionojne ne nivel DAR/ZA-je. Nje element esenzial per perhapjen e praktikave me te mira do ta luajne Qendrat Burimore qe do te krijohen ne cdo gjimnaz, te cilat do te kenë mesues te trajnuar dhe te certifikuar, materiale profesionale te hartuara rishtaz, si dhe praktika te mira te zbatuara gjate projektit.

10- Pajisje e nxenesve te viteve te fundit me **karten rinore europiane**.

Kohezgjatja: Realizimi I ketyre aktiviteteve eshte parashikuart te realizohet ne nje hark kohor prej 24 muajsh.

Stafi i projektit:

Per realizimin efikas te ketyre aktiviteteve dhe iniciativave pervec stafit te projektit do te jene te perfshire ne projekt edhe anetare te brendshem te shkollave te cilet do te jene pergjegjes per organizimin, kordinimin dhe mbeshjtjetjen e aktiviteteve te ndryshme te parashikuara ne projekt, dhe ne vecanti per organizimin e aktiviteteve komunitare.